

Curriculum Vitae e Presidentit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë,  
Z. Marian Banaś



Zoti Marian Banaś u diplomua në Fakultetin e Drejtësisë dhe Administratës në Universitetin e Jagiellonias (1979). Ai gjithashtu ndoqi studime për teologji dhe filozofi në Akademinë Papnore të Teologjisë. Më pas z. Marian Banas plotësoi aplikimin për në gjykatë, të cilin e përfundoi në vitin 1996, me dhënien e provimit për gjykatës dhe njëkohësisht ndoqi trajnimin për auditues pranë Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë. Studimet pasuniversitare, ai ia dedikoi auditimit të brendshëm (2009-2010).

Z. Banaś ishte një nga themeluesit dhe aktivistët (1976-1980) e Aksionit për Pavarësi dhe Institutit të Katyn. Në 1981-1983, z. Marian Banaś vuajti dënimin me burgim për veprimtarinë e tij në lëvizjen Liria e Solidaritetit (Solidarność). Në vitin 1990, atij iu akordua Kryqi i Kalorësit të Urdhrit "Polonia Restituta" nga qeveria polake në mërgim dhe në vitin 2011 Kryqi Zyrtar i Urdhrit "Polonia Restituta" nga Presidenti i Republikës Polake. Z. Banaś gjithashtu ka marrë edhe medaljen "Firmë në fjalë" – nderim që u akordohet shtetasve që prej vitit '80, të cilën rrezikuan shtypjen dhe burgosjen, si dhe vepruan në shërbim të lirisë së fjalës në Poloni. Së fundmi, në vitin 2015, ai mori edhe Kryqin e Lirisë dhe Solidaritetit, nga Presidenti i Republikës, z. Andrzej Duda.

Z. Marian Banaś ishte këshilltar i Ministrisë të Brendshme gjatë qeverisë së z. Jan Olszewski. Në 1992-2015 ai mbajti poste të ndryshme në NIK (ndër të tjera ekspert i vjetër i auditit publik dhe këshilltar juridik). Nga 21 Nëntori 2005 deri më 2 Janar 2008, ai shërbeu si Nënsekretar i Shtetit në Ministrinë e Financave dhe që nga 28 Nëntori 2005 gjithashtu edhe si Shef i Shërbimit Doganor.

Më 19 Nëntor 2015, ai u emërua Nëndrejtor i Shtetit në Ministrinë e Financave, dhe më 9 Dhjetor 2016, Sekretar i Shtetit, si dhe Shef i Administratës Kombëtare të të Ardhurave dhe Shërbimit Doganor. Z. Banaś gjithashtu ka mbajtur pozicionet e Inspektorit të Përgjithshëm të Informacionit Financiar dhe atë të Komisionerit Qeveritar për Luftimin e Mashtrimit në Republikën e Polonisë dhe Bashkimin Evropian.

Që nga 4 qershori 2019 deri në zgjedhjen si President i NIK ka mbajtur postin e Ministrisë të Financave të Polonisë.

Z. Marian Banamerret me sport dhe është trajner karate. Ai është bashkëshort dhe baba.